

Prezantim i llojlojshmërisë në prodhimtarinë bujqësore me përdorimin e teknikave inovative dhe praktikave dhe mundësi të rritura për financim dhe mobilizim të mjeteve

PRODHIME TË REJA PËR ZHVILLIM LOKAL NË RAJONIN E OHRIT-STRUGËS

HYRJE

Rajoni Jugperëndimor i Planifikimit perspektivat e saj për zhvillimin e mëtejshëm e sheh në avancimin e turizmit klasik dhe zhvillimin e formave alternative, siç janë turizmi dimëror, shëndetësor, manastire, bujqësor dhe ekologjik. Duke marrë parasysh faktin që gjithë rajoni nuk ka ndodhje, ka potenciale të mëdha edhe për prodhimtarinë e ushqimit organik.

Komunat Ohër dhe Strugë disponojnë me një fond të pasur të resurseve autentike kulturore, natyrore dhe tradicionale dhe produkte që në përputhje me trendin global gjatë dekadave të fundit në zhvillimin rural dhe turizëm ofrojnë mundësi serioze për zhvillimin e rajonit të Ohrit-Strugës dhe përmirësim të cilësisë së jetës në pjesët rurale të këtyre dy komunave. Në kohën e njëjtë, aspekti autentik i produkteve tradicionale nga popullata lokale është një bazë e mirë për krijimin e një koncepti specifik të nxitjes së zhvillimit rural.

Rajoni i Ohrit-Strugës si një prej rajoneve më të mëdha dhe më të zhvilluar turistik në Republikën e Maqedonisë ka nevojë për produkte të llojlojshme që do të pasurojnë ofertën turistike. Programet kombëtare për bujqësi, zhvillim rural dhe turizëm në Maqedoni shkojnë në dobi të krijimit të vetë-qëndrueshmërisë në rajonet rurale me anë të zhvillimit të bujqësisë dhe veprimtarive plotësuese në rajonet rurale (fshatrat). Zhvillimi rural dhe turizmi rural, individualisht, me anë të shembujve të ndryshme në komunat Ohër dhe Strugë, vetëm më tregojnë interesin e turistëve, përfitimet për popullatën lokale dhe komunitetin afarist - ndonëse ende mungojnë struktura të përcaktuara të degës.

ZBULIME KRYESORE

Në përgjithësi, numri i turistëve në Rajonin Jugperëndimor ka shënuar një rritje gjatë 5 viteve të fundit: prej 250 mijë vizitorë në vitin 2012, deri më 350 mijë vizitorë në vitin 2017 (ESHS, 2018). Në veçanti është shënuar rritja e turistëve të huaj, prej të cilëve një pjesë e tyre është interesuar për një lloj tjetër të turizmit dhe dëshirojnë të mësojnë për kulturën lokale, ushqimin tradicional dhe produktet.

Rajoni i Ohrit-Strugës disponon me resurse dhe produkte autentike kulturore, natyrore dhe tradicionale. Zhvillimi rural dhe turizmi ofrojnë mundësi serioze për zhvillimin e këtij rajoni dhe përmirësim të cilësisë së jetës në pjesët ruralet të komunave të Ohrit dhe Strugës.

Vendosja e produkteve bujqësore në tregjet lokale kontribuon për një zhvillim më të lartë të bujqësisë lokale dhe rritje të konkurrencës. Sektori i hotelerisë, veçanërisht në funksion të turizmit, është relativisht mirë i zhvilluar në Rajonin Jugperëndimor të Planifikimit dhe është një konsumator i madh i produkteve bujqësore, andaj, paraqitet nevoja edhe vendosjes së lidhjeve më të fuqishme dhe rrjeteve mes këtyre sektorëve. Me zbatimin e masave përkatëse, do të kontribuohet për përmirësimin e cilësisë së produkteve bujqësore që drejt do të ndikojnë mbi rritjen e të ardhurave të mjediseve rurale dhe rritje të zhvillimit ekonomik.

Të gjithë palët e interesuar që janë të përfshirë në zinxhirin e ushqimit, sot janë të përballuar me mundësi më të mëdha të tregut, por gjithashtu edhe kërcënime, që janë të krijuar me miratimin e standardeve dhe rregullave të përbashkëta të tregut. Konkurrenca e rritur i detyron prodhuesit e ushqimit në rajon të fillojnë të zbatojnë metoda bashkëkohore për përmirësimin e prodhimitarisë bujqësore me anë të miratimit të inovacioneve teknike në këtë fushë. Transferimi i njohurisë është një faktor i rëndësishëm që kontribuon për adaptimin e suksesshëm të bujqësisë, si në lidhje me lëvizjet e tregut, ashtu edhe në lidhje me ndryshimet klimatike. Prodhimtaria e integruar kontribuon për përmirësimin e miratimit me ferma për vendosjen e praktikave të qëndrueshme bujqësore. Me anë të kësaj mënyre të prodhimitarisë ndikohet mbi uljen e fenomenit të shpërndarjes dhe përdorimit masiv të tepruar të produkteve kimike në bujqësi, gjegjësisht plehra kimike dhe pesticide, që mund të kenë ndikim negativ mbi ujin, dheun, ajrin dhe llojlojshmërinë biologjike.

Në dekadën e fundit gjithnjë e më tepër bëhet aktuale zhvillimi i turizmit ekologjik. Turizmi ekologjik shpesh përzihet me termin turizmi i fshatit, një term që turizmi ekologjik përzihet dhe plotësohet. Turizmi ekologjik tërheq më pak njerëz, por njerëz që kanë kërkesa specifike dhe janë të gatshëm për të shpenzuar. Turistët gjithnjë e më tepër kanë nevojë për kënaqje në natyrë të pastër. Oferta zgjerohet me aktivitete siç janë kalërimi i gomarëve në f. Velestovë dhe f. Kuraticë, kënaqje në peizazhet, mësimi për florën dhe faunën.

Me zhvillimin e turizmit malor, përveç atij të liqeneve, do të mbaheshin më tepër turistët dhe do të rriste sezonin turistike për disa muaj në vit. Si shembull i suksesshëm, në 20 km nga Ohri dhe 1109 metra lartësi mbidetare, fshati Kuraticë me 220 banorë ekziston dhe me sukses zhvillon turizëm të fshatrave më tepër se një dekadë, që prej viti në vit tërheq gjithnjë e më shumë turistë nga Evropa. Në këtë pjesë të Ohrit, gjenden fshatrat malore që me sukses punojnë në zhvillimin e turizmit malor dhe rural, dhe ato janë: f. Zavoje, f. Openicë, f. Reçicë dhe f. Skrebatno. Banorët e këtyre fshatrave mund të ofrojnë ushqim tradicional që është specifik për këtë rrethinë dhe fruta mali që janë autoktone dhe rriten vetëm në këtë pjesë dhe janë organike, të pa trajtuar me lënë kimike. Ka të pranishëm mollë që nuk është trajtuar me lënë kimike, çaje

mali, dardha, kërpudha dhe tjera. Gjithashtu, në komunën Strugë me hapa të mëdhenj zhvillohen viset malore Gorna Belica dhe Vishni. E përbashkët për këto vise dhe mjedise rurale është që kusht për përmirësimin e këtij lloji të turizmit është përmirësimi i infrastrukturës.

DREJTIME DHE REKOMANDIME

Duhet një sërë masash për nxitjen e formave alternative të turizmit në Rajonin e Ohrit-Strugës. Nga ana e Rrjetit të Fermerëve të Rinj (RrFR) dhe Shoqata Kortet Kuraticë do të bëhet një hartë e potencialeve për turizëm ekologjik dhe aktivitetet për turistët në Ohër dhe rrethinë, ndërsa ana e Shoqatës Rubankult dhe Matica nga Struga e njëjta do të bëhet në Strugë dhe rrethinë. Pastaj, bashkërisht do të mendohet për aktivitete që do të jenë interesante për turistët aktual dhe tërheqjen e të rejave, me qëllim të fundit të zhvillimit të viseve rurale dhe ruajtje të mjedisit jetësor.

Në drejtim të ruajtjes së aspektit autentik të prodhimtarisë bujqësore, produktet tradicionale dhe plotësimi i turizmit rural, duhet të ndërmerren hapat vijues:

- Përforsimi i ofertës së turizmit rural me anë të rritjes së llojllojshmërisë së produkteve lokale,
- Promovimi i produkteve tradicionale dhe autoktone me teknika inovative të marketingut,
- Analizë e mundësive për mbrojtje të produkteve lokale me shenjë të origjinës,
- Zhvillimi i kanaleve të shpërndarjes dhe shitjes së produkteve lokale bujqësore të Rajonit të Ohrit-Strugës,
- Nxitje të turizmit bujqësor,
- Promovim të masave bujqësore-ekologjike dhe përforsim të kapaciteteve të fermerëve për prodhimtari ekologjike,
- Bashkimi i prodhuesve lokal të ushqimit organik,
- Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm me anë të prezantimit të formave alternative të produkteve ekologjike (kopshte botanike, atribute natyrore të mjedisit jetësor në Rajonin e Ohrit-Strugës, flora dhe fauna, shëtitje ornitologjike, shëtitje lepidopterlogjike...)
- Motivim i të rinjve me anë të edukimit për prodhimtari inovative dhe shpërndarje të produkteve,
- Përforsimi i kapaciteteve të të rinjve në këtë rajon me anë të trajnimeve për BE dhe fonde tjera të zhvillimit rural dhe turizmit,
- Shembuj pozitiv të fermerëve të suksesshëm të rinj,
- Marrja e masave që do të përforsojnë jetën dhe frymën sociale në mjediset rurale, si shtytës kryesor i zhvillimit të një komuniteti (përforsimi i rolit dhe strukturës së komuniteteve lokale, trajnime, vizita studimore, hapje të debateve me popullatën lokale dhe tjera).

KONKLuzion

Përveç formave tradicionale të turizmit në Rajonin e Ohrit-Strugës, paraqitet edhe nevoja për produkte të reja dhe lloje të reja të ofertës turistike. Aspekti autentik i produkteve tradicionale

nga popullata lokale është një bazë e mirë për krijimin e një koncepti specifik të nxitjes së zhvillimit rural në komunat. Lidhja e prodhuesve me tregun, gjegjësisht gjithë zinxhiri i prodhimtarisë, prej dheut në tryezë dhe shpërndaja në treg është një problem, që nëse arrihet zgjidhje, do të nxit prodhimtarinë bujqësore dhe në kuptimin ekonomik do të përforcojë rajonin. Turizmi, si rural dhe ashtu ekologjik, do të hap më tepër mundësi për ofertë më të llojlojshme në rajon.

Me anë të masave të propozuar, që janë kyçese për përforcimin e kushteve sociale ekonomike në këtë rajon, veçanërisht në mjediset rurale, do të nxitet zhvillimi dhe mbijetesa e komunitetit, të rinjtë do të jenë më të motivuar të qëndrojnë në vendlindje dhe do të zhvillohet vetëdija ekologjike dhe fryma sipërmarrëse. Gjithashtu, këto masa do të kontribuojnë për zgjerimin dhe rritjen e ofertës turistike në treg dhe përgjigje të kërkesave specifike të grupeve të synimit.

BURIMET

MMJPH (2014) Plani i Tretë Kombëtar për Ndryshime Klimatike, Turizmi dhe Ndryshimet Klimatike, Vlerësimi i Prekshmërisë dhe Rekomandime për Adaptim. Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Shkup.

CRJPR (2015) Program për Zhvillimin e Rajonit Jugperëndimor të Planifikimit 2015-2019. Qendra për Zhvillimin e Rajonit Jugperëndimor të Planifikimit, Strugë.

Komuna e Ohrit (2014) Strategjia e Ultë për Zhvillim Rural e Komunës së Ohrit 2014-2018, Sektori për turizëm dhe Zhvillim Lokal Ekonomik, Ohër.

ESHS (2018) Turistë dhe Fjetje, grafikë informative. Enti Shtetëror i Statistikës, Shkup.

INFORMACIONE PLOTËSUESE

Rrjeti i Fermerëve të Rinj -RrFR, f. Mesheishte, Debarcë, www.mmf.mk

Shoqata Ortet – Kuraticë

Kurban Kult, www.rurbankult.mk

Shoqata Matica – Strugë, www.matica.com